



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 52**

**14 maj**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 42/2012 datë 19.4.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat.....	2639
Ligj nr. 43/2012 datë 19.4.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre përkatëse.....	2654
Vendim i Kuvendit nr. 19/2012 datë 19.4.2012	Për emërimin e zonjës Iva Zajmi anëtare të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.....	2669
Vendim i Kuvendit nr. 20/2012 datë 19.4.2012	Për emërimin e Zotit Koço Broka anëtar të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.....	2669
Vendim i Kuvendit nr. 21/2012 datë 26.4.2012	Për zgjatjen e afatit të komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, ngritur me vendimin nr.141, datë 17.11.2011...	2670
Rezolutë e Kuvendit datë 26.4.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Drejtues të RTSH-së për vitin 2011.....	2670
Rezolutë e Kuvendit datë 26.4.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2011.....	2671
Rezolutë e Kuvendit datë 19.4.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2011.....	2672

Dekret nr. 7401 datë 16.4.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2674
Dekret nr. 7421 datë 24.4.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2674
Dekret nr. 7423 datë 27.4.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	2675

**LIGJ**  
**Nr. 42/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË  
SË SHTETIT TË KATARIT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE  
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së shtetit të Katarit për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimin mbi të ardhurat.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 19.4.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7424, datë 30.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE  
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e shtetit të Katarit,  
*me dëshirën* për të lidhur një marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe  
parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat,  
kanë rënë dakord si më poshtë.

**Neni 1**

**Personat e përfshirë**

Kjo marrëveshje zbatohet për persona të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.



## Neni 2 Tatimet e përfshira

1. Kjo marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat që vendosen në emër të një shteti kontraktues ose të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve vendore, pavarësisht nga mënyra në të cilën vendosen.

2. Konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet që vendosen mbi të ardhurat në tërësi ose mbi elemente të të ardhurave.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet marrëveshja janë:

a) në rastin e Shqipërisë:

i) tatimet mbi të ardhurat (*the income taxes*), duke përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive (*including corporate profits tax*), tatimin mbi të ardhurat personale (*personal income tax*) dhe tatimin e të ardhurave kapitale nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme ose të paluajtshme (*capital gains tax from the alienation of the movable or immovable property*); dhe

ii) tatimi i aktiviteteve të biznesit te vogël (*the tax on small business activities*) (më poshtë quhet “tatimi shqiptar”).

b) në rastin e Katarit:

Tatimet mbi të ardhurat ose fitimet (më poshtë quhet “tatimi i Katarit”); dhe

4. Marrëveshja zbatohet edhe për çdo tatim të njëjtë ose në thelb të ngjashëm që vendoset pas datës së nënshkrimit të marrëveshjes si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të konsiderueshëm që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

## Neni 3 Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termi “Shqipëri” është Republika e Shqipërisë dhe, nëse përdoret në kuptimin gjeografik, është territori i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi të, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, që në bazë të ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, është në zonën brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar dhe nëntokën, dhe burimet e tyre natyrore;

b) Termi “Katar” është territori i shtetit të Katarit, ujërat territoriale, deti territorial, duke përfshirë shtratin dhe nëntokën, hapësirën ajrore mbi ta, zonën ekonomike ekskluzive dhe shelfin kontinental mbi të cilin shteti i Katarit ushtron të drejtat sovrane dhe juridiksionin në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe ligjet dhe rregulloret e brendshme të Katarit.

c) Termat “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” janë Katari ose Shqipëria, siç e kërkon konteksti.

d) Termi “person” përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo organizim tjetër personash.

e) Termi “shoqëri” është një person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllimet tatimore.

f) Termi “ndërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” është përkatësisht një ndërmarrje e marrë përsipër nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje e marrë përsipër nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues.

g) Termi “trafik ndërkombëtar” është çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje që ka selinë e menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveç kur anija ose avioni operohet vetëm ndërmjet vendeve në shtetin tjetër kontraktues;

h) Termi “autoritet kompetent” është:  
i) në rastin e Shqipërisë, Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;  
ii) në rastin e Katarit, Ministri i Ekonomisë dhe Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;  
dhe

j) Termi “shtetas”, në lidhje me një shtet kontraktues është:  
i) çdo individ që ka shtetësinë e atij shteti kontraktues;  
ii) çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që e përfton statusin e saj si e tillë nga ligjet në fuqi në atë shtet kontraktues.

2. Gjatë zbatimit të dispozitave të marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term që nuk është i përkufizuar në të, përveç kur konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka në atë moment sipas ligjit të atij shteti për qëllimet tatimore për të cilat zbatohet marrëveshja.

#### Neni 4 **Rezidenti**

1. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi “rezident i një shteti kontraktues” nënkupton:  
a) Në rastin e Shqipërisë, çdo person, i cili, sipas ligjeve të Shqipërisë, u nënshtrohet tatimeve në të për shkak të vendqëndrimit, vendbanimit, vendit të menaxhimit ose një kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin gjithashtu Shqipërinë dhe çdo nënndarje politike ose autoritet vendor të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin personat, të cilët nuk u nënshtrohen tatimeve në Shqipëri në lidhje vetëm me të ardhurat nga burimet në Shqipëri.

b) Në rastin e Katarit, çdo individ që ka një banesë të përhershme, qendër me interes jetik ose vendqëndrim të zakonshëm në Katar dhe një shoqëri e themeluar ose që ka vendin e menaxhimit efektiv në Katar. Termi përfshin gjithashtu shtetin e Katarit dhe çdo nënndarje politike, autoritet lokal ose organ ligjor të tij.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja shtetet kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) Ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetikë).

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetikë nuk mund të përcaktohet ose nëse nuk ka banesë të përhershme në dispozicion në asnjë shtet kontraktues, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një vendbanim të zakonshëm.

c) nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja shtetet kontraktuese ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit nga i cili është shtetas;

d) nëse statusi i vendqëndrimit të një individi nuk mund të përcaktohet në pajtim me dispozitat e nënparagrafëve “a”, “b” dhe “c” më sipër, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka vendin e menaxhimit efektiv.

#### Neni 5 **Njësia e përhershme**

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, termi “njësi e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.



2. Termi “njësi e përhershme” përfshin në veçanti:

- a) një vend menaxhimi;
- b) një degë;
- c) një zyrë;
- d) një fabrikë;
- e) një punishte;
- f) ambientet që përdoren si pikë shitjeje;
- g) një fermë ose plantacion; dhe
- h) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose një vend tjetër të kërkimit, nxjerrjes

ose shfrytëzimit të burimeve natyrore.

3. Termi “njësi e përhershme” përfshin gjithashtu:

a) Një kantier ndërtimi, një projekt ndërtimi, montimi ose instalimi ose një aktivitet mbikëqyrës në lidhje me këtë kantier ose projekt, por vetëm nëse ky kantier, projekt apo aktivitet vazhdon për një periudhë ose periudha që së bashku përbëjnë më shumë se gjashtë muaj brenda dymbëdhjetë muajve; dhe

b) Dhënien e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këtë qëllim, por vetëm nëse aktivitetet e kësaj natyre (për të njëjtin projekt ose të lidhur me të) brenda një shteti kontraktues për një periudhë ose periudha që së bashku përbëjnë më shumë se gjashtë muaj brenda dymbëdhjetë muajve.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “njësi e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, dorëzimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të kryerjes nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës; ose

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 7, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka, dhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në atë shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi kufizohen në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë vend të caktuar biznesi njësi të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, një ndërmarrje sigurimi e një shteti kontraktues, përveçse në lidhje me risigurimin, konsiderohet të ketë një njësi të përhershme në shtetin tjetër kontraktues nëse ajo mbledh premie në territorin e atij shteti kontraktues ose siguron rreziqet që gjenden atje nëpërmjet një personi, të ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 7.

7. Një ndërmarrje nuk konsiderohet të ketë njësi të përhershme në një shtet kontraktues

vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë në ushtrim të zakonshëm të biznesit të tyre. Megjithatë, nëse aktivitetet e këtij agjenti i përkushtohen tërësisht ose pothuaj tërësisht në emër të asaj ndërmarrjeje dhe ndërmjet ndërmarrjes dhe agjentit janë vendosur kushte në marrëdhëniet e tyre tregtare dhe financiare, të cilat ndryshojnë nga ato që do të ishin vendosur ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, ai nuk do të konsiderohet agjent me status të pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi.

8. Fakti që një shoqëri e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një njësie të përhershme ose ndryshe), nuk tregon se një prej këtyre shoqërive është njësi e përhershme e shoqërisë tjetër.

#### Neni 6

#### **Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme**

1. Të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që gjenden në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe të ardhurat nga pasuria e paluajtshme që përdoren për kryerjen e shërbimeve të pavarura personale.

#### Neni 7

#### **Fitimet nga biznesi**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të taten në shtetin tjetër, por vetëm për ato që i takojnë asaj njësie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur atje, fitimet të cilat mund të pritej të nxirrtë nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme, dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen njësi e përhershme e së cilës ajo është, në secilin shtet kontraktues do t'i atribuohen atij vendqëndrimi të përhershëm.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një njësie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të biznesit të njësisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të bëra qoftë në shtetin ku ndodhet njësi e përhershme ose gjetkë, të cilat lejohen sipas dispozitave të ligjit të brendshëm të shtetit kontraktues në të cilin ndodhet njësi e përhershme.



4. Për sa kohë që është e zakonshme në një shtet kontraktues të përcaktohen fitimet që i atribuohen një njësie të përhershme mbi bazën e një ndarjeje të fitimeve totale të ndërmarrjes në pjesë të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk përjashton atë shtet kontraktues nga përcaktimi i fitimeve që do të taton nga kjo ndarje, siç mund të jetë e zakonshme; megjithatë, metoda e zbatuar për ndarjet do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet në përmbajtje të këtij neni.

5. Asnjë fitim nuk i atribuohet një njësie të përhershme vetëm për shkak të blerjes nga ajo njësi e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

6. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen njësisë së përhershme përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do cenohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

### **Transporti me anije dhe avion**

1. Fitimet nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në atë shtet kontraktues në të cilin ndodhet menaxhimi efektiv i ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i menaxhimit efektiv i ndërmarrjes dërguese është në bordin e një anijeje, ai konsiderohet të jetë në shtetin kontraktues në të cilin gjendet porti i regjistrimit të anijes ose nëse nuk ka port regjistrimi, në shtetin kontraktues rezident i të cilit është operatori i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një partneritet, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

#### Neni 9

### **Ndërmarrjet e asociuara**

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues,

dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet të dyja ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare, të cilat ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim, që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe si rrjedhim të taton.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti, dhe rrjedhimisht taton, fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatuar në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis të dyja ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm në sasinë e tatimeve të vendosura në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e kësaj përshtatjeje, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, sipas rastit, konsultohen me njëra-tjetrën.



## Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të taten gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 5 për qind të shumës bruto të dividendëve.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2, dividendët e përmendur në paragrafin 1 janë të tatueshëm vetëm në shtetin kontraktues në të cilin pronari përfitues është rezident, nëse:

a) pronari përfitues është një shtet kontraktues, një nënndarje politike, një pushtet lokal, një subjekt ligjor ose banka qendrore e tij;

b) në rastin e Katarit, pronari përfitues është një prej subjekteve të mëposhtme, për aq kohë sa të jenë në pronësi të Katarit:

i) autoriteti i investimeve të Katarit;

ii) Qatar Holding;

iii) fondi i Katarit për pensionet;

iv) Banka për Zhvillim e Katarit; dhe

v) çdo institucion tjetër, që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese;

c) në rastin e Shqipërisë, pronari përfitues është një prej subjekteve të mëposhtme, për aq kohë sa të jenë në pronësi të Shqipërisë:

i) Banka e Shqipërisë;

ii) të gjitha subjektet tërësisht në pronësi të shtetit;

iii) çdo institucion tjetër që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

4. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet ose të drejta të tjera që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime, si dhe çdo e ardhur tjetër nga të drejtat e shoqërive që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatimor, si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit kontraktues në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që gjendet atje dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

6. Kur një shoqëri e cila është rezidente e një shteti kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër nuk mund të vendosë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me njësinë e përhershme të vendosur në atë shtet tjetër dhe as nuk do t’ia nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatim mbi fitimet e pashpërndara edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.



## Neni 11 Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatohet në shtetin kontraktues ku rrjedh interesi në pajtim me ligjet e atij shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk tejkalon 5 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi i përmendur në paragrafin 1 është i tatueshëm vetëm në shtetin kontraktues ku pronari përfitues është rezident, nëse:

a) pronari përfitues është një shtet kontraktues, një nënndarje politike, një autoritet vendor, një subjekt ligjor ose banka qendrore e tij;

Në rastin e Katarit, pronari përfitues është një prej subjekteve të mëposhtme, për aq kohë sa të jenë në pronësi të Katarit:

i) autoriteti i investimeve të Katarit;

ii) Qatar Holding;

iii) fondi i Katarit për pensionet;

iv) Banka për Zhvillim e Katarit; dhe

v) çdo institucion tjetër, që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese;

b) në rastin e Shqipërisë, pronari përfitues është një prej subjekteve të mëposhtme, për aq kohë sa të jenë në pronësi të Shqipërisë:

i) Banka e Shqipërisë;

ii) të gjitha subjektet tërësisht në pronësi të shtetit;

iii) çdo institucion tjetër që mund të bihet dakord herë pas here ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

4. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i garantuar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë premiet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit. Gjjobat për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllimet e këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 nuk zbatohen, nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lind interesi, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse që gjendet në të dhe detyrimi i borxhit në lidhje me të cilin është paguar interesi është efektivisht i lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur paguesi është rezident i vetë atij shteti, i një nënndarjeje politike, autoriteti vendor ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një njësi të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo njësi e përhershme ose bazë fikse, atëherë interesi konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet njësia e përhershme ose baza fikse.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e

përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke i kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 12

### **Tarifat e licencave**

1. Tarifat e licencave që lindin në një shtet kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, taten vetëm në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto tarifa licencash mund të taten gjithashtu në shtetin kontraktues ku ato lindin dhe në pajtim me ligjet e atij shteti, por nëse pronari përfitues i tarifave të licencave është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i ngarkuar nuk kalon 6 për qind të shumës bruto të tarifave të licencave.

3. Termi “tarifat e licencave” siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore (duke përfshirë filmat kinematografikë dhe filmat, regjistrimet në shirit ose disqe për transmetim në radio ose televizion), çdo patentë, markë tregtare, dizeno ose model, plan, formulë ose proces sekret ose për përdorim, ose të drejtën për të përdorur pajisjet industriale tregtare ose shkencore apo për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk zbatohen, nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues në të cilin lindin tarifatat e licencave, nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në shtetin tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë fikse që gjendet në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen tarifatat e licencave, është e lidhur efektivisht e lidhur me këtë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, sipas rastit.

5. Tarifatat e licencave konsiderohen të lindin në një shtet kontraktues nëse paguesi është rezident i atij shteti. Megjithatë, nëse personi që paguan tarifatat e licencave, qoftë rezident i një shteti kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një njësi të përhershme ose bazë fikse në lidhje me të cilën është shkaktuar detyrimi për të paguar tarifatat e licencave dhe këto tarifa licencash mbulohen nga kjo njësi e përhershme ose bazë fikse, këto tarifa licencash konsiderohen të lindin në shtetin në të cilin ndodhet njësia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumata e tarifave të licencave, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilën ata paguhen, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

## Neni 13

### **Fitimet kapitale**

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pronës së biznesit të një njësie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues ose të



pasurisë së luajtshme që i përket një baze fikse të disponueshme nga një rezident i një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontaktues për qëllimin e kryerjes së shërbimeve personale të pavarura, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj njësie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose e kësaj baze fikse, mund të taten në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurisë së luajtshme që i përket operimit të këtyre anijeve ose avionëve, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e përfuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve, që marrin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone, të ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

### Shërbime personale të pavarura

1. Të ardhurat e përfuara nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me shërbimet profesionale ose aktivitetet e tjera të një karakteri të pavarur janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveçse në rrethanat e mëposhtme, kur këto të ardhura mund të taten në shtetin tjetër kontraktues:

a) Nëse ai ka një bazë fikse rregullisht të disponueshme prej tij në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tij; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i përket asaj baze fikse mund të taten në shtetin tjetër kontraktues; ose

b) Nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër kontraktues është për një periudhë ose periudha më të gjata që janë të barabarta ose kalojnë në tërësi 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në të njëjtin vit fiskal përkatës; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që përftohet nga aktivitetet e tij të kryera në shtetin tjetër mund të taten në shtetin tjetër kontraktues.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore ose mësimdhënie, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, juristëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe kontabilistëve.

#### Neni 15

### Shërbime personale të varura

1. Në bazë të dispozitave të nenit 16, 18 dhe 19, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, janë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përftohet atje mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përfuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, është i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse:

a) përfituesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 (njëqind e tetëdhjetë e tri) ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore, e cila fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm, të cilin punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përfuar nga një punësim i

ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni të operuar në trafikun ndërkombëtar mund të tatohet në atë shtet në të cilin gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

#### Neni 16

#### **Tarifat e drejtuesve**

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve të një shoqërie e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

#### Neni 17

#### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues si argëtues, si artist teatri, filmi, radioje apo televizioni, muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale, si të tilla të ushtruara në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist, nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti por nga një person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Të ardhurat e përfutuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga aktivitetet e ushtruara në shtetin tjetër kontraktues sipas parashikimit të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni përjashtohen nga tatimi në atë shtet tjetër nëse vizita në atë shtet tjetër mbështetet plotësisht ose kryesisht nga fondet e një shteti kontraktues, një nënndarje politike ose autoritet lokal i tij, ose kryhet në bazë të një marrëveshjeje ose mase kulturore ndërmjet qeverive të shteteve kontraktuese.

#### Neni 18

#### **Pensionet dhe pagesat vjetore**

1. Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 19, pensionet e paguara në lidhje me punësimin e kaluar ose shpërblimet apo pagesat vjetore të tjera që i paguhen rezidentit të një shteti kontraktues tatohen vetëm në atë shtet.

2. Termi “pagesë vjetore” është një shumë e caktuar që paguhet periodikisht në afate të caktuara gjatë gjithë jetës ose gjatë një periudhe kohe të caktuar ose të përcaktueshme nën detyrimin e bërjes së pagesave të shlyerjes për shpërblimin e përshtatshëm ose të plotë në para, ose në vlerë paraje.

#### Neni 19

#### **Shërbimi qeveritar**

1. a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të paguara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike ose autoritet lokal një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje ose autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga ose shpërblime të tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti dhe që:

i) është shtetas i atij shteti; ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.



2. a) Çdo pension i paguar nga ose nga fondet e krijuara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike apo autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje apo autoritet, janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension është i tatueshëm vetëm në shtetin tjetër kontraktues nëse individ është një rezident dhe shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16, 17 dhe 18 të kësaj marrëveshjeje zbatohen për rrogat, pagat, dhe shpërblime të tjera të ngjashme, dhe pensionet në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose nënndarje e tij politike ose autoritet lokal i tij.

#### Neni 20

#### **Mësuesit dhe kërkuesit**

1. Nëse një individ i cili është ose ishte menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues një rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe me ftesë të qeverisë së shtetit të parë kontraktues ose të një universiteti, kolegji, shkolle, muzeu ose institucioni kulturor të shtetit të parë kontraktues, apo në bazë të një programi zyrtar të shkëmbimit kulturor, është i pranishëm në atë shtet kontraktues për një periudhë që nuk kalon 2 vjet të njëpasnjëshëm vetëm për qëllimin e mësimit, dhënies së leksioneve ose kryerjes së kërkimit në këtë institucion, përjashtohet nga tatimet në atë shtet kontraktues në lidhje me shpërblimin nga ky aktivitet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen për të ardhurat nga kërkimi nëse ky kërkim ndërmerret jo në interes publik, por kryesisht për përfitime private të një personi apo personave specifikë.

#### Neni 21

#### **Studentët, praktikantët e biznesit dhe stazhierët**

1. Pagesat që merr një student ose praktikant biznesi apo stazhier, i cili është ose ishte menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues një rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe i cili është i pranishëm në shtetin e parë kontraktues vetëm për qëllimin e arsimimit dhe trajnimit të tij, për qëllimin e jetesës, arsimimit ose trajnimit nuk taten në atë shtet kontraktues, me kusht që këto pagesa të vijnë nga burime jashtë atij shteti kontraktues.

2. Në lidhje me grandet, bursat dhe shpërblimi nga punësimi që nuk mbulohen nga paragrafi 1, një student, praktikant biznesi ose stazhier i përshkruar në paragrafin 1 ka të drejtën gjatë arsimimit ose trajnimit e të njëjtave përjashtimeve, uljeje dhe zbritjeje në lidhje me tatimet që vendosen për rezidentët e shtetit që ai viziton.

#### Neni 22

#### **Të ardhura të tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të patrajtuara në nenet e mësipërme të kësaj marrëveshjeje janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, të përfuara nga një rezident i një shteti kontraktues, nëse pronari përfitues i këtyre të ardhurave zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një njësie të përhershme të vendosur në të ose kryen në shtetin tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhet të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë njësi të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen sipas rastit, dispozitat e nenit 7 ose nenit 14.

## Neni 23

### Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Në rastin e Katarit, tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

Nëse një rezident i Katarit përfton të ardhura të cilat, në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, janë të tatueshme në Shqipëri, Katari lejon si zbritje nga tatimet mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin e paguar në Shqipëri, me kusht që kjo zbritje të mos kalojë pjesën e tatimit që llogaritet para së të bëhen zbritjet, që u përkasin të ardhurave të përfuara në Shqipëri.

2. Në rastin e Shqipërisë, tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura që, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të taten në Katar, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Katar.

Kjo zbritje në çdo rast nuk tejkalon atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat që llogariten para se të bëhet zbritja, që u përket të ardhurave që mund të taten në Katar.

b) Nëse në pajtim me një dispozitë të marrëveshjes, të ardhurat e përfuara të një rezidenti të Shqipërisë përjashtohen nga tatimi në Shqipëri, Shqipëria megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, termi “tatime të paguara” konsiderohet të përfshijë shumën e tatimit, i cili do të paguhej në një shtet kontraktues, nëse nuk do të jepej një përjashtim ose zbritje në pajtim me ligjet dhe rregulloret e atij shteti kontraktues.

## Neni 24

### Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen tatimit apo ndonjë kërkesë në lidhje me të në shtetin tjetër kontraktues që është e ndryshme ose është më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse të cilave u nënshtrohen ose mund t’u nënshtrohen shtetasit e atij shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht dispozitave të nenit 1, zbatohet edhe për personat të cilët nuk janë rezidentë të një ose të dyja shteteve kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi të cilët janë rezidentë të një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen në asnjë shtet kontraktues ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të që është e ndryshme ose është më e rëndë sesa tatimi dhe kërkesat përkatëse të cilave u nënshtrohen ose mund t’u nënshtrohen shtetasit e atij shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën.

3. Tatimi mbi një njësi të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk interpretohet sikur detyrohet një shtet kontraktues për t’u dhënë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues shtesa, ulje apo zbritje personale për qëllime tatimore në emër të statusit civil apo përgjegjësiive familjare që ai u jep rezidentëve të vet.

4. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, të paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 6 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t’i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë.

5. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk u nënshtrohen asnjë tatimi ose kërkesë në lidhje me të në shtetin e përmendur më parë, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat përkatëse të cilave mund t’u nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.



6. Mostatimi i shtetasve të Katarit sipas ligjit tatimor të Katarit nuk konsiderohet si diskriminim sipas dispozitave të këtij neni.

7. Në këtë nen, termi “tatim” do të thotë tatimet që janë objekt i kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 25

### **Procedura e marrëveshjes së ndërsjellë**

1. Kur një person konsideron se veprimet e një ose të dyja shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t’ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose, nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 24, të shtetit kontraktues në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiket të zgjidhë çështjen me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim shmangien e tatimit që nuk është në pajtim me këtë marrëveshje.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, ata mund të konsultohen së bashku për shmangien e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet një komisioni të përbashkët që përbëhet prej tyre dhe përfaqësuesve të tyre, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

#### Neni 26

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë atë informacion që mendohet të jetë i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje ose për administrimin apo zbatimin e ligjeve të brendshme të shteteve kontraktuese në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimin e caktuar në emër të shteteve kontraktuese ose të nënndarjeve të tyre politike ose autoriteteve lokale, në masën që, tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues trajtohet si i fshehtë në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohe vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në seanca gjyqësore me dyer të hapura ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të japin informacion që nuk është i përfutueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administrimit në atë ose shtetin tjetër kontraktues;



c) të japin informacion që do të zbulonte çdo sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike.

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues përdor masat e tij për mbledhjen e informacionit për të marrë informacionin e kërkuar, megjithëse atij shteti tjetër mund të mos i duhet ky informacion për qëllimet e tij tatimore. Detyrimi që gjendet në fjalinë e mësipërme u nënshtrohet kufizimeve të paragrafit 3 të këtij neni, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit thjesht pasi nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar ose një person që vepron në një agjenci, ose cilësi mirëbesimi, ose pasi ai ka të bëjë me interesa pronësie të një personi.

#### Neni 27

#### **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe zyrave konsullore**

Asgjë në këtë marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose zyrave konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

#### Neni 28

#### **Hyrja në fuqi**

1. Shtetet kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, mbi përfundimin e procedurës së kërkuar nga ligjet e tyre për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit të këtyre njoftimeve.

2. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje kanë fuqi:

a) Në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, në lidhje me shumatat e paguara ose të kredituara më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin hyn në fuqi marrëveshja; dhe

b) Në lidhje me tatimet e tjera, në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin hyn në fuqi marrëveshja.

#### Neni 29

#### **Përfundimi i marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të përfundohet nga një prej shteteve kontraktuese. Secili shtet kontraktues mund ta përfundojë këtë marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke bërë njoftim me shkrim për përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik që fillon pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj.

2. Kjo marrëveshje pushon së qeni në fuqi:

a) Në lidhje me tatimin e mbajtur në burim, në lidhje me shumatat e paguara ose të kredituara më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin bëhet njoftimi; dhe

b) Në lidhje me tatimet e tjera, në lidhje me vitet fiskale që fillojnë më ose pas datës 1 janar të vitit kalendarik menjëherë pas vitit në të cilin bëhet njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Tiranë, më 18 tetor 2011, në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëllëj autentike. Në rast mospërputhjeje, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.



**LIGJ**  
**Nr. 43/2012**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA  
ARABE PËR SHËRBIMET AJRORE NDËRMJET DHE PËRTEJ TERRITOREVE TË TYRE  
PËRKATËSE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për shërbimet ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre përkatëse.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.4.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7425, datë 30.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE PËR SHËRBIMET AJRORE  
NDËRMJET DHE PËRTEJ TERRITOREVE TË TYRE PËRKATËSE**

Hyrje

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Emirateve të Bashkuara Arabe (më poshtë të quajtura “palët kontraktuese”),

*duke qenë* palë në konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1944;

*me dëshirën* për të lidhur një marrëveshje në pajtim me dhe si shtesë e kësaj konvente, për qëllimin e vendosjes dhe operimit të shërbimeve ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre përkatëse;

*duke njohur* rëndësinë e transportit ajror si mjet i krijimit dhe forcimit të miqësisë, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve të të dyja vendeve;

*me dëshirën* për të lehtësuar zgjerimin e mundësive ndërkombëtare të transportit ajror, kanë rënë dakord si më poshtë.

## Neni 1 Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termi:

a) “Autoriteti aeronautik” është në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, në cilësinë e Autoritetit të Aviacionit Civil; dhe në rastin e Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe, Autoriteti i Përgjithshëm i Aviacionit Civil; ose në çdo rast çdo person ose organ i autorizuar të përmbushë çdo funksion me të cilin ka lidhje kjo marrëveshjeje.

b) “Shërbimet e rëna dakord” janë shërbimet ajrore ndërkombëtare të planifikuara ndërmjet dhe përtej territoreve përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe për transportin e pasagjerëve, bagazhit dhe mallrave, veçmas ose në çdo kombinim.

c) “Marrëveshje” është kjo marrëveshjeje, aneksi i përpiluar në zbatim të saj dhe çdo ndryshim i marrëveshjes ose aneksit.

d) “Shërbim ajror”, “linjë ajrore”, “shërbim ajror ndërkombëtar” dhe “ndalim jo për qëllime trafiku” kanë kuptimet e caktuara atyre përkatësisht në nenin 96 të konventës.

e) “Aneksi” përfshin grafikun e itinerarit bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje dhe çdo klauzolë ose shënim që gjendet në këtë aneks dhe çdo ndryshim i bërë për të në pajtim me dispozitat e nenit 20 të kësaj marrëveshjeje.

f) “Mallrat” përfshin postën.

g) “Konventë” është konventa për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, e hapur për nënshkrim në Çikago, më 7 dhjetor 1944, dhe përfshin: i) çdo ndryshim të saj që ka hyrë në fuqi sipas nenit 94 (a) të konventës dhe është ratifikuar nga të dyja palët kontraktuese; dhe ii) çdo aneks ose ndryshim i miratuar për të sipas nenit 90 të asaj Konvente, në masën që ky aneks ose ndryshim është në një kohë të caktuar në fuqi për të dyja palët kontraktuese.

h) “Linjat ajrore të caktuara” është një linjë ose linja ajrore që janë caktuar dhe autorizuar në pajtim me nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.

i) “Këshilli i Ministrave”, në rastin e Shqipërisë është Qeveria e Shqipërisë.

j) “Tarifa” janë çmimet që kërkohen për transportin e pasagjerëve, bagazhit dhe mallrave dhe kushtet në të cilat zbatohen ato çmime, por duke përfshirë shpërblimin dhe kushtet për transportin e postës.

k) “Territor” në lidhje me një shtet ka kuptimin e caktuar atij në nenin 2 të konventës.

l) “Tarifa të përdoruesit” janë tarifatat që u vendosen linjave ajrore nga autoritetet kompetente ose që lejohen prej tyre për t’u vendosur për ofrimin e ambienteve aeroportuale, pronës dhe/ose pajisjeve të navigimit, duke përfshirë shërbimet dhe mjetet përkatëse për avionin, ekuipazhin, pasagjerët, bagazhin dhe mallrat e tyre.

## Neni 2 Dhënia e të drejtave

1. Secila palë kontraktuese i jep palës tjetër kontraktuese të drejtat e përcaktuara në këtë marrëveshjeje për t’u mundësuar linjave ajrore të caktuara të vendosin dhe operojnë shërbimet e rëna dakord.

2. Linjat ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese gëzojnë të drejtat e mëposhtme:

a) për të fluturuar mbi territorin e palës tjetër kontraktuese pa u ulur;

b) për të bërë ndalime në territorin e palës tjetër kontraktuese jo për qëllime trafiku; dhe

c) për të bërë ndalime në territorin e palës tjetër kontraktuese për qëllimin e imbarkimit dhe/ose zbarkimit në trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve, bagazhit dhe mallrave, veçmas ose në çdo kombinim, ndërsa operohen shërbimet e rëna dakord.



3. Për më tepër, linja(t) ajrore të secilës palë kontraktuese, të ndryshme nga ato të caktuara sipas nenit 3, gëzojnë edhe të drejtat e përcaktuara në paragrafët 2(a) dhe 2(b) të këtij neni.

4. Asnjë në këtë nen nuk konsiderohet t'u japë linjave ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese privilegjin e imbakimit në territorin e palës tjetër kontraktuese të pasagjerëve, bagazhit dhe mallrave të transportuara me shpërblim ose si shërbim dhe të destinuara për një pikë tjetër brenda territorit të asaj pale tjetër kontraktuese.

5. Nëse për shkak të konfliktit të armatosur, trazirave ose zhvillimeve politike ose rrethanave të veçanta ose të pazakonta, një linjë ajrore e caktuar e një pale kontraktuese nuk është në gjendje të operojë një shërbim në itinerarin e saj normal, pala tjetër kontraktuese bën përpjekjet e saj më të mira për të lehtësuar operimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve nëpërmjet rirregullimit të përkohshëm të përshtatshëm të itinerareve që vendoset reciprokisht nga palët kontraktuese.

6. Linjat ajrore të caktuara kanë të drejtë të përdorin të gjitha linjat ajrore, aeroportet dhe ambiente të tjera të ofruara nga palët kontraktuese mbi një bazë jodiskriminuese.

### Neni 3

#### **Caktimi dhe autorizimi**

1. Autoriteti aeronautik i secilës palë kontraktuese ka të drejtën të caktojë një ose më shumë linja ajrore për qëllimin e operimit të shërbimeve të rëna dakord dhe të tërheqë ose të ndryshojë caktimin e kësaj linje ajrore ose të zëvendësojë një linjë tjetër ajrore në vend të njëres të caktuar më parë. Një caktim i tillë mund të përcaktojë objektin e autorizimit të dhënë çdo linjeje ajrore në lidhje me operimin e shërbimeve të rëna dakord. Caktimet dhe ndryshimet e tyre bëhen me shkrim nga autoriteti aeronautik i palës kontraktuese që ka linjën ajrore drejtuar Autoritetit aeronautik të palës tjetër kontraktuese.

2. Me marrjen e një njoftimi për caktimin, zëvendësimin ose ndryshimin dhe me kërkesën e linjës ajrore të caktuar në formën dhe mënyrën e parashikuar, pala tjetër kontraktuese, në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, i jep pa vonesë linjës(ave) ajrore të caktuar(a) autorizimet operuese të përshtatshme.

3. Autoriteti aeronautik i një pale kontraktuese mund të kërkojë një linjë ajrore të caktuar nga pala tjetër kontraktuese t'i bindë ata që është e kualifikuar për të përmbushur kushtet e parashikuara sipas ligjeve dhe rregulloreve që zbatohen normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme për operimin e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga një autoritet i tillë, në përputhje me dispozitat e konventës.

4. Secila palë kontraktuese ka të drejtën të refuzojë autorizimet operuese të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni ose të vendosë ato kushte që i konsideron të nevojshme për ushtrimin nga linja ajrore e caktuar të të drejtave të përcaktuara në paragrafin 2(c) të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, në çdo rast kur, në pajtim me çdo marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve kontraktuese, nuk është e mundur që pronësia thelbësore dhe kontrolli efektiv i asaj linje ajrore nuk i takon palës kontraktuese që cakton linjën ajrore ose të shtetasve të saj.

5. Nëse një linjë ajrore është caktuar dhe autorizuar, ajo mund të fillojë në çdo kohë të operojë shërbimet e rëna dakord plotësisht ose pjesërisht, me kusht që të vendoset një grafik kohor në pajtim me nenin 15 të kësaj marrëveshjeje në lidhje me këto shërbime.

### Neni 4

#### **Revokimi dhe kufizimi i autorizimit operativ**

1. Autoriteti aeronautik i secilës palë kontraktuese, në lidhje me një linjë ajrore të caktuar nga pala tjetër kontraktuese, ka të drejtën të revokojë një autorizim operativ ose të pezullojë

ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje ose të vendosë kushte, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, siç mund ta çmojë të nevojshme për ushtrimin e atyre të drejtave:

a) Në rastin e mosrespektimit nga ajo linjë ajrore të ligjeve dhe rregulloreve që zbatohen normalisht dhe në mënyrë të arsyeshme nga autoriteti aeronautik i palës kontraktuese që jep ato të drejta në pajtim me konventën, ose

b) Në rast se linja ajrore ndryshe nuk operon në pajtim me kushtet e parashikuara sipas kësaj marrëveshjeje; ose

c) Në çdo rast kur, në pajtim me një marrëveshje të veçantë ndërmjet palëve kontraktuese, nuk është e bindur që pronësia thelbësore dhe kontrolli efektiv i asaj linje ajrore nuk i takon palës kontraktuese që cakton linjën ajrore ose të shtetasve të saj; ose

d) Në pajtim me paragrafin 6 të nenit 10 të kësaj marrëveshjeje;

e) Në rastin e mosmarrjes së masave të përshtatshme nga pala tjetër kontraktuese për të përmirësuar sigurinë në pajtim me paragrafin 2 të nenit 10 të kësaj marrëveshjeje; ose

f) Në çdo rast kur pala tjetër kontraktuese nuk respekton një vendim ose parashikim që rrjedh nga zbatimi i nenit 19 të kësaj marrëveshjeje.

2. Përveç kur revokimi, pezullimi ose vendosja e menjëhershme e kushteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni është thelbësor për parandalimin e shkeljeve të ligjeve ose rregulloreve, kjo e drejtë ushtrohet vetëm pas konsultimit me autoritetin aeronautik të palës tjetër kontraktuese, sipas parashikimit të nenit 18.

3. Në rastin e një veprimi nga një palë kontraktuese sipas këtij neni, të drejtat e palës tjetër kontraktuese sipas nenit 19 nuk cenohen.

#### Neni 5

#### **Parimet që rregullojnë operimin e shërbimeve të rëna dakord**

1. Secila palë kontraktuese lejon reciprokisht linjat ajrore të caktuara të të dyja palëve kontraktuese të konkurrojnë lirisht në ofrimin e transportit ajror ndërkombëtar të rregulluar nga kjo marrëveshje.

2. Secila palë kontraktuese merr të gjitha masat e përshtatshme brenda juridiksionit të saj për të eliminuar të gjitha format e diskriminimit dhe praktikat antikonkurruese ose të pandershme në ushtrimin e të drejtave dhe titujve të parashikuar në këtë marrëveshje.

3. Nuk ka kufizim në kapacitetin dhe numrin e frekuencave dhe/ose tipit(ave) të avionëve që operohen nga linjat ajrore të caktuara të të dyja palëve kontraktuese në çdo lloj shërbimi (pasagjerë, mallra, veçmas ose të kombinuara). Secila linjë ajrore e caktuar lejohet të përcaktojë frekuencën dhe kapacitetin që ajo ofron në shërbimet e rëna dakord.

4. Asnjë palë kontraktuese nuk kufizon në mënyrë të njëanshme volumin e trafikut, frekuencave, rregullsinë e shërbimit ose tipit(ave) të avionëve që operohen nga linjat ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese, përveç kur kjo mund të kërkohet për kërkesat doganore, teknike, operative ose mjedisore sipas kushteve uniforme, në pajtim me nenin 16 të konventës.

5. Asnjë palë kontraktuese nuk u vendos linjave ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese, një kërkesë të refuzimit të parë, raportin e ngritjes, tarifë moskundërshtimi ose ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me kapacitetin, frekuencat e trafikut që nuk do të ishin në pajtim me qëllimet e kësaj marrëveshjeje.



## Neni 6

### Detyrimet doganore dhe tarifa të tjera

1. Secila palë kontraktuese përjashton linjat ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese nga kufizimet e importit, detyrimet doganore, tatimet e drejtpërdrejta ose të tërthorta, tarifatat e inspektimit dhe të gjitha detyrimet e tjera kombëtare dhe/ose lokale dhe detyrimet mbi avionin, si dhe pajisjet, karburantin, lubrifikantët, pajisjet e mirëmbajtjes, veglat e avionit, furnizimet teknike të konsumueshme, pjesët e këmbimit duke përfshirë motorët, rezervat e avionit, duke përfshirë pa u kufizuar në artikuj, të tillë si: ushqime, pije, likere, duhan dhe produkte të tjera për shitje ose përdorim nga pasagjerët gjatë fluturimit dhe artikuj të tjerë që janë të destinuar ose përdoren vetëm në lidhje me operimin ose shërbimin e avionit që përdoren nga kjo linjë ajrore e caktuar që operon shërbimet e rëna dakord, si dhe biletat gjendje të printuara, dokumentet e fluturimit, uniformat e personelit, kompjuterët dhe printerët e biletave që përdoren nga linja ajrore e caktuar për rezervimet dhe dhënien e biletave, çdo material i printuar që ka logon e linjës ajrore të caktuar të printuar në të dhe materialet e zakonshme të publicitetit dhe promocionale që shpërndahen falas nga kjo linjë ajrore e caktuar.

2. Përjashtimet e dhëna nga ky nen zbatohen për artikujt e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni që:

a) prezantohen në territorin e një pale kontraktuese nga ose në emër të një linje ajrore të caktuar të palës tjetër kontraktuese;

b) mbahen në bordin e avionit të një linje ajrore të caktuar të një pale kontraktuese me mbërritjen të ose deri në largimin nga territori i palës tjetër kontraktuese dhe/ose konsumohen gjatë fluturimit mbi atë territor;

c) merren në bordin e avionit të një linje ajrore të caktuar të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe destinohen për përdorim në operimin e shërbimeve të rëna dakord; pavarësisht nëse këta artikuj përdoren ose konsumohen plotësisht ose pjesërisht brenda territorit të palës kontraktuese që jep përjashtimin, me kusht që këta artikuj të mos tjetërsohen në territorin e kësaj pale kontraktuese.

3. Pajisjet e rregullta ajrore, si dhe materialet, furnizimet dhe rezervat që normalisht mbahen në bordin e avionit që përdoret nga linja ajrore e caktuar e palës tjetër kontraktuese mund të shkarkohen në territorin e palës tjetër kontraktuese vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të asaj pale tjetër kontraktuese. Në këtë rast, këto pajisje dhe artikuj gëzojnë përjashtimet e parashikuara nga paragrafi 1 i këtij neni, me kusht që ato mund të kërkohen të vihen nën mbikëqyrjen e këtyre autoriteteve deri në momentin që rieksportohen ose disponohen ndryshe, në pajtim me rregulloret e doganave.

4. Përjashtimet e parashikuara nga ky nen zbatohen gjithashtu në situatat kur linjat ajrore të caktuara të një pale kontraktuese kanë bërë marrëveshje me një linjë(a) tjetër për dhënien hua ose transferimin në territorin e palës tjetër kontraktuese të pajisjeve të rregullta dhe artikujve të tjerë që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, me kusht që linja tjetër ajrore të gëzojë të njëjtin(at) përjashtim(e) nga ajo palë kontraktuese.

## Neni 7

### Zbatimi i ligjeve dhe i rregulloreve të brendshme

1. Ligjet, rregulloret dhe procedurat e një pale kontraktuese në lidhje me pranimin, ndalimin ose largimin nga territori i saj i avionit të përfshirë në navigimin ajror ndërkombëtar ose për operimin dhe navigimin e këtij avioni ndërsa është në territorin e saj, zbatohen për avionin e operuar nga linja(t) ajrore të palës tjetër kontraktuese pa dallim në lidhje me shtetësinë, siç zbatohen për të

vetat dhe respektohen nga ky avion gjatë hyrjes, largimit dhe gjatë qëndrimit në territorin e asaj pale kontraktuese.

2. Ligjet, rregulloret dhe procedurat e një pale kontraktuese në lidhje me pranimin, qëndrimin ose largimin nga territori i saj i pasagjerëve, bagazhit, ekuipazhit dhe mallrave të transportuara në bordin e avionit, që janë rregulloret në lidhje me hyrjen, zhdoganimin, sigurinë e aviacionit, imigrimin, pasaportat, doganat, monedhën, shëndetin, karantinën dhe masat sanitare ose në rastin e postës, ligjet dhe rregulloret postare respektohen nga ose në emër të pasagjerëve, bagazhit, ekuipazhit dhe mallrave gjatë hyrjes dhe largimit, si dhe gjatë qëndrimit në territorin e palës së parë kontraktuese.

3. Asnjë palë kontraktuese nuk mund të japë preferencë për linjën(at) ajrore të vet(a) ose të tjera ndaj linjës(ave) ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të parashikuara në këtë nen.

4. Pasagjerët, bagazhi dhe mallrat në transit të drejtpërdrejtë mbi territorin e një pale kontraktuese dhe që nuk largohen nga zonat e aeroportit të rezervuara për këtë qëllim, përveçse në lidhje me masat e sigurisë kundër dhunës, piraterisë ajrore, kontrollit të narkotikëve, nuk i nënshtrohen më shumë se një kontrolli të thjeshtë. Ky bagazh dhe mall përjashtohet nga detyrimet doganore, taksa e akcizës dhe tarifa ose detyrime të tjera të ngjashme kombëtare dhe/ose lokale.

#### Neni 8

#### **Ndarja e kodit**

1. Linja(t) ajrore të caktuara të të dyja palëve kontraktuese, si transportues marketimi ose si transportues operimi, hyjnë lirisht në masa bashkëpunuese marketimi, duke përfshirë por pa u kufizuar në masat për hapësirën e bllokuar dhe/ose ndarjen e kodit (duke përfshirë masat për ndarjen e kodit në vende të treta), me çdo linjë ose linja të tjera ajrore.

2. Para dhënies së shërbimeve për ndarjen e kodit, partnerët e ndarjes së kodit bien dakord për palën që është përgjegjëse në lidhje me përgjegjësinë dhe çështjet në lidhje me klientët, sigurinë dhe lehtësimin. Marrëveshja që parashikon këto kushte depozitohet tek autoritetet aeronautike para zbatimit të masave për ndarjen e kodit.

3. Këto masa pranohen nga autoritetet aeronautike përkatëse, me kusht që të gjitha linjat ajrore në këto masa të kenë të drejtat themelore të trafikut dhe/ose autorizimet.

4. Në rastin e një mase për ndarjen e kodit, linja ajrore e marketimit në lidhje me çdo biletë të shitur, siguron që është bërë e qartë për blerësin në pikën e shitjes se cila linjë ajrore do të operojë faktikisht çdo sektor shërbimi dhe me cilën linjë ose linja ajrore blerësi po hyn në një marrëdhënie kontraktuale.

5. Linja(t) ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese mund të ofrojnë gjithashtu shërbime të ndarjes së kodit ndërmjet çdo pike(ave) në territorin e palës tjetër kontraktuese, me kusht që këto shërbime të operohen nga një linjë ose disa linja ajrore të palës tjetër kontraktuese.

#### Neni 9

#### **Certifikatat e përshtatshmërisë për fluturim dhe të kompetencës**

1. Certifikatat e përshtatshmërisë për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose vleftësuar nga një palë kontraktuese dhe që janë ende në fuqi njihen si të vlefshme nga pala tjetër kontraktuese për qëllimin e operimit të shërbimeve të rena dakord, gjithmonë me kusht që këto certifikata ose licenca të jenë lëshuar ose vleftësuar në pajtim dhe në përputhje me standardet minimale të caktuara sipas konventës.



2. Megjithatë, secila palë kontraktuese rezervon të drejtën të refuzojë njohjen për fluturimet mbi territorin e tij të certifikatave të kompetencës dhe licencave të lëshuara për shtetasit e tij nga pala tjetër kontraktuese.

3. Nëse privilegjet ose kushtet e licencave ose certifikatave të lëshuara ose vleftësuar nga një palë kontraktuese lejojnë një ndryshim nga standardet e caktuara sipas konventës, pavarësisht nëse ky ndryshim është depozituar tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, Autoriteti Aeronautik i palës tjetër kontraktuese, pa cenuar të drejtat e palës së parë kontraktuese sipas nenit 10(2), mund të kërkojë konsultime me Autoritetin Aeronautik të palës tjetër kontraktuese në pajtim me nenin 18, me qëllim bindjen se praktika në fjalë është e pranueshme për to. Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme përbën shkak për zbatimin e nenit 4(1) të kësaj marrëveshjeje.

#### Neni 10

#### Siguria e aviacionit

1. Secila palë kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë për standardet e sigurisë në çdo zonë në lidhje me ekuipazhin e avionit, avionin ose operimin e tyre të miratuar nga pala tjetër kontraktuese. Këto konsultime zhvillohen brenda 30 ditëve nga kjo kërkesë.

2. Nëse pas këtyre konsultimeve, një palë kontraktuese konstaton se pala tjetër kontraktuese nuk mban dhe administron në mënyrë efektive standardet e sigurisë në ndonjë nga këto fusha që janë të paktën të barabarta me standardet minimale të vendosura në atë kohë në pajtim me konventën, pala e parë kontraktuese njofton palën tjetër kontraktuese për ato konstatime dhe hapat që konsiderohen të nevojshëm për të përmbushur ato standarde minimale dhe që pala tjetër kontraktuese të ndërmarrë masat e përshtatshme korrigjuese. Mosmarrja e masave të përshtatshme nga pala tjetër kontraktuese brenda 15 ditëve ose për një periudhë më të gjatë, siç mund të bihet dakord, përbën shkak për zbatimin e nenit 4(1) të kësaj marrëveshjeje.

3. Bihet dakord që çdo avion i operuar nga një linjë ajrore e një pale kontraktuese për shërbimet për në ose nga territori i palës tjetër kontraktuese, ndërsa brenda territorit të palës tjetër kontraktuese mund të bëhen subjekt ekzaminimi i përfaqësuesve të autorizuar të palës tjetër kontraktuese, në bord dhe rreth avionit për të verifikuar vlefshmërinë e dokumenteve të avionit dhe ato të ekuipazhit dhe gjendjen e dukshme të avionit dhe pajisjeve të tij (në këtë nen quhet “inspektimi *ramp*”), me kusht që kjo të mos shkaktojë vonesë të paarsyeshme.

4. Nëse një inspektim i tillë *ramp* ose një sërë inspektimesh *ramp* shkaktojnë:

a) probleme serioze që avioni ose operimi i avionit nuk përmbush standardet minimale të vendosura në atë kohë në pajtim me konventën; ose

b) probleme serioze që ka mungesë të mirëmbajtjes dhe mirëmbajtjes efektive të standardeve të caktuara në atë kohë në pajtim me konventën,

pala kontraktuese që kryen inspektimin, për qëllimet e nenit 33 të konventës, është e lirë të nxjerrë përfundimin që kërkesat në bazë të të cilave është lëshuar ose vleftësuar certifikata ose licencat në lidhje me atë avion ose ekuipazhin e atij avioni ose kërkesat në bazë të të cilave ai avion operohet, nuk janë të barabarta ose mbi standardet minimale të caktuara në bazë të konventës.

5. Në rastin kur hyrja për qëllimin e ndërmarrjes së një inspektimi *ramp* të një avioni të operuar nga një linjë ajrore e një pale kontraktuese në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni mohohet nga një përfaqësues i asaj linje ajrore, pala tjetër kontraktuese është e lirë të nxjerrë përfundimin që linden probleme serioze të tipit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni dhe të nxjerrë përfundimet e përmendura në atë paragraf.

6. Secila palë kontraktuese rezervon të drejtën të pezullojë ose ndryshojë autorizimin operativ të një linje ose disa linjave ajrore të palës tjetër kontraktuese menjëherë në rast se pala e parë kontraktuese nxjerr përfundimin që, qoftë si rezultat i një inspektimi *ramp*, një sërë



inspektimesh *ramp*, një mohimi hyrjeje për inspektim *ramp*, konsultimeve ose ndryshe, që veprimi i menjëhershëm është thelbësor për sigurinë e operimit të një linje ajrore.

7. Çdo veprim nga një palë kontraktuese në pajtim me paragrafët 2 ose 6 të këtij neni ndërpritet menjëherë sapo baza për marrjen e atij veprimi pushon së ekzistuari.

#### Neni 11

### **Tarifat e përdoruesit**

1. Secila palë kontraktuese bën përpjekjet e saj maksimale për të siguruar që tarifat e përdoruesit të caktuara ose të lejuara për t'u caktuar nga organet e saj kompetente për caktimin mbi linjat ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese për përdorimin e aeroporteve dhe ambienteve të tjera të aviacionit të jenë të drejta dhe të arsyeshme. Këto tarifa bazohen në parimet e qëndrueshme ekonomike dhe nuk janë më të larta se ato që paguhen nga linjat ajrore të tjera për këto shërbime.

2. Asnjë palë kontraktuese nuk u jep preferencë, në lidhje me tarifat e përdoruesit, linjave të veta ose të tjera ajrore të përfshira në shërbime të ngjashme ndërkombëtare ajrore dhe nuk cakton ose lejon caktimin mbi linjën(at) ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese të tarifave të përdoruesit që janë më të larta se ato që caktohen për linjën(at) e vet(a) ajrore të caktuar(a) dhe që operon shërbime të ngjashme ndërkombëtare ajrore që përdorin avionë dhe pajisje dhe shërbime përkatëse të ngjashme.

3. Secila palë kontraktuese inkurajon konsultime ndërmjet organeve kompetente të caktimit të tarifave dhe linjave ajrore të caktuara që përdorin shërbimet dhe ambientet. Kurdoherë që është e mundur, bëhet njoftim i arsyeshëm për këta përdorues për çdo propozim për ndryshime në tarifat e përdorimit së bashku me informacionin dhe të dhënat përkatëse mbështetëse, për t'u mundësuar atyre të shprehin mendimet e tyre para rishikimit të tarifave.

#### Neni 12

### **Siguria e aviacionit**

1. Në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, palët kontraktuese rikonfirmojnë që detyrimi i tyre ndaj njëra-tjetrës për të mbrojtur sigurinë e aviacionit civil ndaj akteve të formave të paligjshme të ndërhyrjes përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

2. Pa kufizuar përgjithësimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas të drejtës ndërkombëtare, palët kontraktuese veçanërisht veprojnë në pajtim me dispozitat e konventës mbi veprat penale dhe akte të tjera të caktuara të kryera në bordin e avionit, të nënshkruara në Tokio, më 14 shtator 1963, konventës për shtypjen e kapjes së paligjshme të avionëve, nënshkruar në Hagë, më 16 dhjetor 1970, konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil, të nënshkruar në Montreal, më 23 shtator 1971, dhe protokollit për shtypjen e veprimeve të paligjshme të dhunës në aeroporte që shërbejnë për Aviacionin Ndërkombëtar Civil të konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së Aviacionit Civil, të nënshkruar në Montreal, më 23 shtator 1971, të nënshkruar në Montreal, më 24 shkurt 1988, dhe çdo marrëveshjeje tjetër që rregullon sigurinë e aviacionit civil që është detyruese për të dyja palët kontraktuese.

3. Palët kontraktuese i japin njëra-tjetrës, me kërkesë, të gjithë ndihmën e nevojshme për të parandaluar veprimet e kapjes së paligjshme të avionit civil dhe veprimet e tjera të paligjshme kundër sigurisë së këtij avioni, pasagjerëve dhe ekuipazhit të tij, aeroporteve dhe pajisjeve të navigacionit ajror dhe çdo kërcënim tjetër përkatës për sigurinë e aviacionit civil.

4. Palët kontraktuese, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, veprojnë në pajtim me dispozitat për sigurinë e aviacionit, të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil dhe që janë



përcaktuar si anekse të konventës në masën që këto dispozita për sigurinë janë të zbatueshme për palët kontraktuese.

5. Përveç kësaj, palët kontraktuese kërkojnë që operatorët e avionit të regjistrit të tyre ose operatorët e avionit që kanë vendin kryesor të biznesit të tyre ose vendqëndrimin e përhershëm në territorin e tyre dhe operatorët e aeroporteve në territorin e tyre të veprojnë në pajtim me këto dispozita të sigurisë së avionit që janë të zbatueshme për palët kontraktuese.

6. Secila palë kontraktuese bie dakord që operatorëve të saj të avionit mund t'u kërkojë të respektojë dispozitat e sigurisë së aviacionit të përmendura në paragrafin 4 të mësipërm, të zbatuara nga palët e tjera kontraktuese për hyrjen, largimin ose gjatë qëndrimit në territorin e asaj pale tjetër kontraktuese.

7. Secila palë kontraktuese garanton që masat të zbatohen në mënyrë efektive brenda territorit të saj për të mbrojtur avionin dhe për të siguruar kontrollin e pasagjerëve, ekuipazhit dhe sendet e mbartura dhe të kryhen kontrole të përshtatshme sigurie për bagazhin, mallrat dhe rezervat e avionit para imbarkimit ose zbarkimit. Secila palë kontraktuese bie dakord gjithashtu të shqyrtojë pozitivisht çdo kërkesë nga pala tjetër kontraktuese për masa të arsyeshme dhe të veçanta sigurie për të përballuar një kërcënim të veçantë.

8. Kur ndodh një incident ose kërcënim i një incidenti për kapjen e paligjshme të avionit civil ose veprime të tjera të paligjshme kundër sigurisë së këtij avioni, pasagjerëve dhe ekuipazhit, pajisjeve të aeroporteve dhe të navigimit ajror, palët kontraktuese ndihmojnë njëra-tjetrën duke lehtësuar komunikimet dhe masat e tjera të përshtatshme të destinuara për të eliminuar këtë kërcënim ose incident sa më shpejt që të jetë e mundur proporcionalisht me rrezikun më të ulët për jetën nga ky incident ose kërcënim.

9. Secila palë kontraktuese merr ato masa që i konsideron të mundshme për të garantuar që avioni i palës tjetër kontraktuese, i cili i është nënshtuar një veprimi kapjeje të paligjshme ose veprimeve të tjera të ndërhyrjes së paligjshme që është ulur në terrenin e tij, të ndalojë atje përveç kur largimi i tij bëhet i domosdoshëm nga detyrimi prioritar për të mbrojtur jetët e pasagjerëve dhe të ekuipazhit.

10. Kur një palë kontraktuese ka arsye të arsyeshme për të besuar që pala tjetër kontraktuese është shmangur nga dispozitat e këtij neni, Autoriteti Aeronautik i palës së parë kontraktuese mund të kërkojë konsultime të menjëhershme me Autoritetin Aeronautik të palës tjetër kontraktuese. Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e kësaj kërkesë përbën shkak për zbatimin e paragrafit 1 të nenit 4 të kësaj marrëveshjeje. Nëse kërkohet nga një gjendje emergjente, një palë kontraktuese mund të marrë një masë të përkohshme sipas paragrafit 1 të nenit 4 para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Çdo masë e marrë në pajtim me këtë paragraf ndërpritet pas respektimit nga pala tjetër kontraktuese të dispozitave të sigurisë së këtij neni.

### Neni 13

#### **Aktivitetet tregtare**

1. Linjat ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese kanë të drejta të hapin në territorin e palës tjetër kontraktuese zyra për qëllimin e nxitjes së transportit ajror dhe shitjen e dokumenteve të transportit, si dhe për produkte dhe mjete të tjera shtesë që kërkohen për ofrimin e transportit ajror.

2. Linjat ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese kanë të drejtë të sjellin dhe mbajnë në territorin e palës tjetër kontraktuese nga personeli dhe përfaqësuesit e tyre menaxherialë, tregtarë, operativë, shitjeve teknike ose tjetër që mund të kërkojë në lidhje me ofrimin e transportit ajror.

3. Këta përfaqësues dhe kërkesat e personelit të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, sipas zgjedhjes së linjës ajrore të caktuar, mund të mjaftohen me personelin e vet të çdo shtetësie ose

me përdorimin e shërbimeve të një linje ajrore, organizate ose shoqërie tjetër që operon në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe që është e autorizuar të ofrojë ato shërbime në territorin e palës tjetër kontraktuese.

4. Linjat ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese, drejtpërdrejt ose në çmimin e tyre, nëpërmjet agjentëve, kanë të drejtë të angazhohen në shitjen e transportit ajror dhe të produkteve dhe të mjeteve plotësuese në territorin e palës tjetër kontraktuese. Për këtë qëllim, linjat ajrore të caktuara kanë të drejtë të përdorin dokumentet e veta të transportit. Linja ajrore e caktuar e secilës palë kontraktuese ka të drejtë të shesë dhe çdo person është i lirë të blejë këtë transport dhe produktet dhe mjetet plotësuese në monedhën e vendit ose në çdo monedhë tjetër lirisht të këmbyeshme.

5. Linjat ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese kanë të drejtën të paguajnë shpenzimet lokale në territorin e palës tjetër kontraktuese në monedhën e vendit ose, nëse kjo është në pajtim me rregulloret e monedhës vendase, në çdo monedhë lirisht të këmbyeshme.

6. Secila palë kontraktuese zbaton kodin e sjelljes të formuluar nga organizata ndërkombëtare e Aviacionit Civil për rregullimin dhe operimin e sistemeve të rezervimit kompjuterik brenda territorit të saj, në pajtim me rregulloret dhe detyrimet e tjera të zbatueshme në lidhje me sistemet e rezervimit kompjuterik.

7. Linjat ajrore të caktuara kanë të drejtë të kryejnë veprimet e veta tokësore në lidhje me operacionet e *check-in-it* në territorin e palës tjetër kontraktuese. Kjo e drejtë nuk përfshin shërbimet e trajtimit tokësor ajror dhe u nënshtrohet vetëm kufizimeve që rrjedhin nga kërkesat e sigurisë së aeroportit dhe infrastrukturës së aeroportit. Nëse konsideratat e sigurisë e përjashtojnë ushtrimin e së drejtës së përmendur në këtë paragraf, këto shërbime të trajtimit tokësor ofrohen pa preferencë ose diskriminim për çdo linjë ajrore të angazhuar në shërbimet e ngjashme ajrore ndërkombëtare.

8. Mbi bazën e reciprocitetit dhe përveç të drejtës së dhënë nga paragrafi 7 i këtij neni, çdo linjë ajrore e caktuar e një pale kontraktuese ka të drejtën të zgjedhë në territorin e palës tjetër kontraktuese, çdo agjent nga agjentët konkurrues të përpunimit të autorizuar nga autoritetet kompetente të asaj pale tjetër kontraktuese për dhënien, pjesërisht ose plotësisht të shërbimeve të përpunimit.

9. Linjat ajrore të caktuara të një pale kontraktuese mund të lejohen gjithashtu të ofrojnë shërbimet e përpunimit tokësor të parashikuara nga paragrafi 7 i këtij neni, pjesërisht ose plotësisht, për linja ajrore të tjera që shërbejnë në të njëjtin aeroport në territorin e palës tjetër kontraktuese.

10. Linjat ajrore të caktuara dhe ofruesit jo të drejtpërdrejtë të transportit ajror të mallrave të të dyja palëve kontraktuese lejohen, pa kufizim, të angazhojnë çdo transport tokësor për mallrat e transportit ajror për në ose nga pikat e territorit të palëve kontraktuese ose në vende të treta duke përfshirë transportin për në ose nga pikat ajrore tek ambientet doganore dhe duke përfshirë, sipas rastit, të drejtën për të transportuar mallra me rrugë ajrore të vulosura nga dogana sipas ligjeve të rregulloreve të zbatueshme. Këto mallra për transport ajror, pavarësisht nëse lëvizin me rrugë tokësore apo ajrore, kanë të drejtën e hyrjes në doganën aeroportuale dhe ambientet e përpunimit. Linjat ajrore të caktuara mund të zgjedhin të kryejnë transportin e tyre tokësor ose ta ofrojnë atë nëpërmjet masave me transportues të tjerë tokësorë, duke përfshirë transportimin tokësor të operuar nga linja të tjera ajrore ose ofrues jo të drejtpërdrejtë të transportit ajror të mallrave. Këto shërbime mallrash të kombinuara mund të ofrohen në një çmim të vetëm për transportin e kombinuar ajror dhe tokësor, me kusht që dërguesve t'u tregohet të lidhje me faktet e këtij transporti.

11. Në lidhje me transportin ajror ndërkombëtar, linjat ajrore të caktuara për secilën palë kontraktuese lejohen të ofrojnë shërbime për pasagjerët në emrin e tyre, nëpërmjet masave bashkëpunuese me ofruesit e transportit tokësor që kanë autoritetin e duhur për të ofruar këtë transport tokësor për në dhe nga çdo pikë në territoret e palëve kontraktuese dhe më tej. Ofruesit e transportit tokësor nuk u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë transportin ajror vetëm për shkak se ky transport tokësor ofrohet nga një linjë ajrore nën emrin e saj. Këto shërbime të



kombinuara mund të ofrohen në një çmim të vetëm për transportin e kombinuar ajror dhe tokësor, me kusht që dërguesve t'u tregohet të lidhje me faktet e këtij transporti. Ofruesit e transportit tokësor kanë diskrecionin për të vendosur nëse do të përfshihen në masa bashkëpunuese të përmendura më sipër. Në vendimmarrjen për një masë të caktuar, ofruesit e transportit tokësor mund të konsiderojnë, ndërmjet të tjerash, interesat e konsumatorëve dhe kufizimet teknike, ekonomike, hapësinore dhe të kapacitetit.

12. Të gjitha aktivitetet e mësipërme kryhen në pajtim me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në fuqi në territorin e palës tjetër kontraktuese.

#### Neni 14

### Transferimi i fondeve

1. Çdo palë kontraktuese u jep linjave ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese të drejtën e transferimit lirisht të tepricës së hyrjeve mbi shpenzimet e fituara nga këto linja ajrore në territorin e saj në lidhje me shitjen e transportit ajror, shitjen e produkteve të shërbimeve të tjera plotësuese, si dhe interesat tregtare të fituara mbi këto të ardhura (duke përfshirë interesin e fituar nga depozitat në pritje të transferimit). Këto transferta kryhen në çdo monedhë të këmbyeshme, në pajtim me rregulloret e këmbimit të huaj të palës kontraktuese në territorin e së cilës mblidhen të ardhurat. Kjo transfertë kryhet mbi bazën e normave zyrtare të këmbimit ose nëse nuk ka kurs zyrtar këmbimi, këto transferta kryhen mbi bazën e normave mbizotëruese të tregut të këmbimit të huaj për këto pagesa.

2. Nëse një palë kontraktuese vendos kufizime mbi transferimin e tepricës së hyrjeve mbi shpenzimet e linjave ajrore të caktuara të palës tjetër kontraktuese, kjo e fundit ka të drejtën të vendosë kufizime reciproke mbi linjat ajrore të caktuara të palës së parë kontraktuese.

3. Në rastin kur ekziston një marrëveshje e veçantë ndërmjet palëve kontraktuese për mënjanimin e tatimit të dyfishtë, ose në rastin kur ka një marrëveshje të veçantë që rregullon transferimin e fondeve ndërmjet të dyja palëve kontraktuese, mbizotëron një marrëveshje e tillë.

#### Neni 15

### Aprovimi i grafikëve

1. Linjat ajrore të caktuara të secilës palë kontraktuese i paraqesin për aprovim autoritetit aeronautik të palës tjetër kontraktuese para inaugurimit të shërbimeve të saj, grafikët e shërbimeve të synuara, duke specifikuar frekuencën, tipin e avionit dhe periudhën e vlefshmërisë. Kjo kërkesë zbatohet edhe për modifikimin e tyre.

2. Nëse një linjë ajrore e caktuar dëshiron të operojë fluturime *ad-hoc* plotësuese për ato të mbuluara në grafikët e aprovuar, ajo merr leje paraprake nga Autoriteti Aeronautik i palës kontraktuese përkatëse, që i kushton kësaj kërkesë një shqyrtim të favorshëm dhe pozitiv.

#### Neni 16

### Tarifat

1. Secila palë kontraktuese lejon që tarifat të vendosen nga secila linjë ajrore e caktuar bazuar në shqyrtimet e saj tregtare në vendin e tregut. Asnjë palë kontraktuese nuk u kërkon linjave ajrore të caktuara të konsultohen me linjat e tjera ajrore në lidhje me tarifat që ato kërkojnë ose propozojnë të kërkojnë.

2. Secila palë kontraktuese mund të kërkojë para depozitimit te autoritetet e saj aeronautike të çmimeve që do të kërkohen për në ose nga territori i linjave ajrore të caktuara të të dyja palëve kontraktuese. Ky depozitim nga ose në emër të linjave ajrore të caktuara mund të kërkohet jo më

shumë se 30 ditë para datës së propozuar të hyrjes në fuqi. Në raste individuale, depozitimi mund të lejohet me afat më të shkurtër nga ai që kërkohet normalisht. Nëse një palë kontraktuese lejon një linjë ajrore të depozitohet një çmim brenda një afati të shkurtër, çmimi hyn në fuqi në datën e propozuar për trafikun me origjinë në territorin e asaj pale kontraktuese.

3. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë nen, asnjë palë kontraktuese nuk ndërmerr masa të njëanshme për të parandaluar inaugurimin ose vazhdimësinë e një çmimi të propozuar të kërkohet ose që kërkohet nga një linjë ajrore e caktuar e një pale kontraktuese për transportin ndërkombëtar ajror.

4. Ndërhyrja nga pala kontraktuese kufizohet në:

a) Parandalimin e tarifave zbatimi i të cilave përbën sjellje antikonkurrencë që ka ose mund të ketë apo destinohet të ketë efektin e dëmtimit të një konkurenti apo përjashtimin e një konkurenti nga itinerari;

b) Mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet që janë tepër të larta ose kufizuese për shkak të abuzimit me pozicionin dominant; dhe

c) Mbrojtjen e linjave ajrore të caktuara nga çmimet që janë artificialisht të ulëta.

5. Nëse një palë kontraktuese beson që një çmim i propozuar të kërkohet nga një linjë ajrore e caktuar e palës tjetër kontraktuese për transportin ndërkombëtar ajror nuk është në pajtim me konsideratat e parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni, ajo kërkon konsultime dhe njofton palën tjetër kontraktuese për shkaqet e pakënaqësisë sa më shpejt të jetë e mundur. Këto konsultime mbahen jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së kërkesës dhe palët kontraktuese bashkëpunojnë në sigurimin e informacionit të nevojshëm për zgjidhjen e arsyeshme të çështjes. Nëse palët kontraktuese arrijnë marrëveshje në lidhje me një çmim për të cilin është bërë një njoftim pakënaqësie, secila palë kontraktuese bën përpjekjet e saj më të mira për t'i dhënë fuqi marrëveshjes. Nëse kjo marrëveshje e përbashkët nuk hyn në fuqi, çmimi ekzistues i mëparshëm vazhdon të mbetet në fuqi.

#### Neni 17

#### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet aeronautike të të dyja palëve kontraktuese shkëmbejnë informacion, sa më shpejt të jetë e mundur, në lidhje me autorizimet faktike të dhëna linjave ajrore të caktuara për të dhënë shërbimet për në transit dhe nga territori i palës tjetër kontraktuese. Kjo përfshin kopjet e certifikatave dhe autorizimeve faktike për shërbimet mbi itineraret e propozuara, së bashku me ndryshimet ose urdhrat e përjashtimit.

2. Autoritetet aeronautike të secilës palë kontraktuese u japin autoriteteve aeronautike të palës tjetër kontraktuese, me kërkesë, ato deklarata periodike ose të tjera statistikore të fluturimeve që janë ngritur dhe ulur në territorin e asaj pale tjetër kontraktuese, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme.

#### Neni 18

#### **Konsultimi**

1. Në frymën e bashkëpunimit të ngushtë, autoritetet aeronautike të palëve kontraktuese konsultohen me njëra-tjetrën herë pas here me qëllim sigurimin e zbatimit dhe respektimit të pranueshëm të dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe secila palë kontraktuese në çdo kohë mund të kërkojë konsultime mbi zbatimin, interpretimin, zbatimin ose ndryshimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Në pajtim me nenet 4, 10 dhe 12, këto konsultime, që mund të jenë nëpërmjet diskutimeve ose korrespondencës, fillojnë brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e marrjes së kësaj kërkesë, përveç kur bihet dakord ndryshe nga të dyja palët kontraktuese.



## Neni 19

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese përpiqen fillimisht ta zgjidhin atë me bisedime.

2. Nëse palët kontraktuese nuk arrijnë një zgjidhje me bisedime, ato mund të bien dakord t'ia referojnë mosmarrëveshjen për vendim një personi ose organi për ndërmjetësim.

3. Nëse palët kontraktuese nuk bien dakord me ndërmjetësimin, ose një zgjidhje nuk arrihet me bisedime, mosmarrëveshja, me kërkesë të një pale kontraktuese, i paraqitet për vendim një gjykate me tre (3) arbitra, që formohet në mënyrën e mëposhtme:

a) Brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës për arbitrazh, secila palë kontraktuese emëron një arbitër. Një shtetas i një shteti të tretë, i cili vepron si kryetar i gjykatës, caktohet si arbitër i tretë nga dy arbitrat e emëruar brenda 60 ditëve nga emërimi i të dytit;

b) Nëse brenda afateve kohore të specifikuar më sipër nuk është bërë një emërim, secila palë kontraktuese i kërkon presidentit të Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil të bëjë emërimin e nevojshëm brenda 30 ditëve. Nëse presidenti është i së njëjtës shtetësi, si dhe një prej palëve kontraktuese, zëvendës-presidenti më i lartë i cili nuk skualifikohet për të njëjtin shkak, bën emërimin. Në një rast të tillë, arbitri ose arbitrat e emëruar nga ky president ose zëvendës-president, sipas rastit, nuk janë shtetas ose me qëndrim të përhershëm në shtetet e palëve të kësaj marrëveshjeje.

4. Përveç kur parashikohet më poshtë në këtë nen ose bihet dakord ndryshe nga palët kontraktuese, gjykata vendos vendin kur do të zhvillohet gjykimi dhe afatet e juridiksionit të tij në pajtim me këtë marrëveshje. Gjukata vendos rregullat e veta procedurale. Një seancë për të përcaktuar çështjet e sakta që duhet të arbitrohen nuk mbahet më vonë se 30 ditë pasi gjykata të jetë formuar tërësisht.

5. Përveç kur bihet dakord ndryshe nga palët kontraktuese ose vendoset nga gjykata, secila palë kontraktuese paraqet një memorandum brenda 45 ditëve pasi të jetë formuar tërësisht gjykata. Përgjigjet bëhen të kërkueshme 60 ditë më vonë. Gjukata mban një seancë me kërkesë të secilës palë kontraktuese ose në çmimin e saj, brenda 30 ditëve pasi të jenë bërë të kërkueshme përgjigjet.

6. Gjukata përpiqet të marrë një vendim me shkrim brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës ose, nëse nuk zhvillohet seancë, 30 ditë pasi të jenë paraqitur përgjigjet. Vendimi merret me shumicë votash.

7. Palët kontraktuese mund të paraqesin kërkesa për sqarimin e vendimit brenda 15 ditëve pasi të ketë marrë vendimin e gjykatës dhe ky sqarim jepet brenda 15 ditëve nga një kërkesë e tillë.

8. Palët kontraktuese respektojnë çdo parashikim, vendim provizor apo vendim përfundimtar të gjykatës.

9. Në pajtim me vendimin përfundimtar të gjykatës, palët kontraktuese mbulojnë shpenzimet e arbitrit të vet dhe një pjesë të barabartë të shpenzimeve të tjera të gjykatës, duke përfshirë çdo shpenzim të bërë nga presidenti ose zëvendës-presidenti i Këshillit të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil në zbatimin e procedurave të paragrafit 3(b) të këtij neni.

10. Nëse dhe për sa kohë një palë kontraktuese nuk përmbush një vendim të parashikuar në paragrafin 8 të këtij neni, pala tjetër kontraktuese mund të kufizojë, pezullojë ose revokojë çdo të drejtë ose privilegj që i ka dhënë sipas kësaj marrëveshjeje palës tjetër kontraktuese në mungesë.

Neni 20

**Ndryshimi i marrëveshjes**

1. Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, nëse një palë kontraktuese e konsideron të dëshirueshme ndryshimin e çdo dispozite të kësaj marrëveshjeje, ky ndryshim bihet dakord në pajtim me dispozitat e nenit 18 dhe realizohet nëpërmjet shkëmbimit të notave diplomatike dhe hyn në fuqi në një datë që caktohet nga palët kontraktuese, dhe kjo datë do të jetë në varësi të përfundimit të procesit të brendshëm të ratifikimit të secilës palë kontraktuese.

2. Çdo ndryshim në aneksin e kësaj marrëveshjeje mund të bihet dakord drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve aeronautike të palëve kontraktuese. Këto ndryshime hyjnë në fuqi nga data për të cilat është rënë dakord.

3. Kjo marrëveshje, duke iu nënshkruar ndryshimeve të nevojshme, konsiderohet të jetë ndryshuar nga ato dispozita të çdo konvente ndërkombëtare ose marrëveshjeje multilaterale që bëhen detyruese për të dyja palët kontraktuese.

Neni 21

**Regjistrimi**

Kjo marrëveshje dhe çdo ndryshim pasues i saj, përveç ndryshimeve në aneks, regjistrohet tek Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil nga shteti ku do të kryhet nënshkrimi i marrëveshjes.

Neni 22

**Aneksi**

Aneksi i kësaj marrëveshjeje konsiderohet si pjesë integrale e saj.

Neni 23

**Përputhja me konventën**

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, palët kontraktuese veprojnë në pajtim me dispozitat e konventës në masën që këto dispozita janë të zbatueshme për shërbimet ndërkombëtare ajrore.

Neni 24

**Prishja e marrëveshjes**

1. Secila palë kontraktuese mund t'i bëjë njoftim në çdo kohë me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike palës tjetër kontraktuese për vendimin për të prishur këtë marrëveshje. Ky njoftim i komunikohet njëkohësisht Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil. Në një rast të tillë, marrëveshja prishet dymbëdhjetë (12) muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga pala tjetër kontraktuese, përveç kur njoftimi për prishjen e saj tërhiqet me marrëveshje para skadimit të këtij afati.

2. Në mungesë të njohjes së marrjes së një njoftimi për prishjen nga pala tjetër kontraktuese, njoftimi konsiderohet të jetë marrë prej saj katërbëdhjetë (14) ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.



## Neni 25 Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn provizorisht në fuqi nga data e nënshkrimit dhe hyn rregullisht në fuqi në ditën që merret njoftimi i fundit me shkrim me notë diplomatike që konfirmon që palët kontraktuese kanë përmbushur të gjitha procedurat e tyre të brendshme përkatëse që kërkohen për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj të poshtëshënuarit, duke qenë për këtë të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në dy kopje në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike dhe secila palë mban një kopje origjinale në secilën gjuhë për zbatim. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

Bërë në Abudabi, në ditën e 30-të të tetorit të vitit 2012.

### ANEKSI GRAFIKU I ITINERARIT

#### SEKSIONI 1 ITINERARET QË OPEROHEN NGA LINJAT AJRORE TË CAKTUARA TË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

<b>Nga</b>	<b>Pika të ndërmjetme</b>	<b>Për në</b>	<b>Tej pikave</b>
Çdo pikë në EBA	Çdo pikë	Çdo pikë në Republikën e Shqipërisë	Çdo pikë

#### SEKSIONI 2 ITINERARET QË OPEROHEN NGA LINJAT AJRORE TË CAKTUARA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

<b>Nga</b>	<b>Pika të ndërmjetme</b>	<b>Për në</b>	<b>Tej pikave</b>
Çdo pikë në Republikën e Shqipërisë	Çdo pikë	Çdo pikë në EBA	Çdo pikë

Operimi i shërbimeve të rëna dakord

1. Linjat ajrore të caktuara të të dyja palëve kontraktuese, në çdo ose të gjitha fluturimet dhe në çmimin e vet, mund të operojnë në secilin ose të dyja drejtimet; ofrojnë shërbime te pikat e ndërmjetme dhe tej tyre në itinerar në çdo kombinim dhe në çdo renditje, të mos bëjnë thirrje në çdo ose të gjitha pikat e ndërmjetme ose tej tyre; ndërpret shërbimet në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe/ose në çdo pikë tej atij territori; ofron shërbime në pikat brenda territorit të secilës palë kontraktuese në çdo kombinim; transferon trafikun nga çdo avion i përdorur prej tyre te një avion tjetër në çdo pikë ose pika në itinerar; kombinon numra të ndryshëm fluturimi brenda një operimi me avion; dhe përdor avionët e vet ose me qira.

2. Linjat ajrore të caktuara të palëve kontraktuese kanë të drejtë të ushtrojnë në çdo lloj shërbimi (pasagjer, mall, veçmas ose të kombinuar), të drejtat e plota të lirisë së pestë të trafikut për në/nga çdo pikë e ndërmjetme ose tej saj pa asnjë lloj kufizimi.



**VENDIM  
Nr. 19/2012**

**PËR EMËRIMIN E ZONJËS IVA ZAJMI ANËTARE  
TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zonja Iva Zajmi emërohet anëtare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 19.4.2012

**VENDIM  
Nr. 20/2012**

**PËR EMËRIMIN E ZOTIT KOÇO BROKA ANËTAR  
TË KOMISIONIT TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Koço Broka emërohet anëtar i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)**

Miratuar në datën 19.4.2012



**VENDIM**  
**Nr. 21/2012**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR  
REFORMËN ZGJEDHORE, NGRITUR ME VENDIMIN NR. 141, DATË 17.11.2011**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Afati i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, ngritur me vendimin nr. 141, datë 17.11.2011, zgjatet deri në datën 15.5.2012.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

Miraturar në datën 26.4.2012

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DREJTUES  
TË RTSH-SË PËR VITIN 2011**

**Kuvendi i Shqipërisë vëren se:**

- Këshilli Drejtues i RTSH-së ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur imazhin e RTSH-së, si një institucion serioz publik kombëtar, siç e përcakton ligji.

- RTSH-ja ka realizuar plotësisht të ardhurat, të cilat janë shpenzuar për veprimtarinë e këtij institucioni në përmirësimin e parametrave cilësorë në shërbim të telespektatorëve.

- Këshilli Drejtues dhe titullarët e RTSH-së janë përpjekur për të realizuar rinovimin e teknologjisë dhe dixhitalizimin, me qëllim që RTSH-ja të jetë konkurrenti kryesor në tregun mediatic, por akoma nuk ka mundur të plotësojë këtë objektiv shumë të rëndësishëm.

- RTSH-ja ka luajtur një rol integruar, duke qenë në qendër të zhvillimeve bashkëkohore midis transmetuesve publikë dhe EBU-së.

**Kuvendi vlerëson se:**

- Janë bërë përpjekje serioze për përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së, duke fituar terren në tregun mediatic, duke nxitur ndjeshëm format sa më gjithëpërfshirëse të dialogimit qytetar, gjë që ka mundur rritjen numerike të dëgjuesit dhe teleshikuesit publik ndaj këtij operatori.

- Janë marrë masa për plotësimin e detyrave të ngarkuara dhe vërejtjeve të bëra për konsolidimin e mëtejshëm të profilit mediatic shoqëror të RTSH-së, duke thelluar reformat dhe qasjet operative tekniko-ligjore e konceptuale.

- Janë bërë shpenzime efikase në shtimin e prodhimit, blerjen e të drejtave ndërkombëtare të veprimtarive të ndryshme sportive, filmave e programeve të ndryshme.

- Një vend të veçantë në emisionet radiotelevizive duhet të zënë emisionet për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar.

- Strukturat e RTSH-së duhet të rrisin efektivitetin e punës së tyre për rritjen e të ardhurave të këtij institucioni, veçanërisht nga realizimi i kontratave të ndryshme me palët e treta për transmetime të ndryshme.

**Për sa më sipër Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së:**

- Të bëjnë përpjekjet maksimale për rinovimin e teknologjisë dixhitale të RTSH-së dhe përshtatjes të saj me stafin e kualifikuar profesional.

- Duke vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së, Kuvendi nxit përdorimin e formave sa më efikase gjithëpërfshirëse të dialogimit qytetar, të cilat mundësojnë ndjekjen në dinamikë nga teleshikuesit dhe dëgjuesit ndaj këtij operatori.

- Me qëllim që të realizohet përmirësimi teknologjik i infrastrukturës teknike të RTSH-së dhe kualifikimi profesional i punonjësve, në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e Përgjithshme e Radiotelevizionit Shqiptar të rrisin rendimentin e punës së strukturave të RTSH-së për rritjen e buxhetit të këtij institucioni mjaft të rëndësishëm, duke siguruar fondet financiare jo vetëm nga Buxheti i Shtetit, taksa mbi aparatën marrës, por edhe nga kontratat me palët e treta për transmetime të ndryshme, shërbime të tjera programesh, botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet etj.

- Të përgatisin personelin teknik, nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe rekrutimit të njerëzve të rinj, të aftë, që i përgjigjen stadi të teknologjisë moderne.

*26 prill 2012*

KRYETARE

**Jozefina Topalli (Çoba)**

## **REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2011**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Nisur nga misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për ushtrimin e kontrollit në subjektet dhe programet publike, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë informacion mbi përdorimin e fondeve buxhetore;

Duke njohur vizionin e këtij institucioni për përdorimin e burimeve me efektivitet, në drejtim të ushtrimit të kontrollit të pavarur, objektiv, të sigurt e të besueshëm;

Mbështetur në detyrimet kushtetuese e ligjore, si dhe në objektivat afatmesëm e ata vjetorë të institucionit;

**Konstaton se gjatë vitit 2011 Kontrolli i Lartë i Shtetit:**

- Ka realizuar detyrat sasiore e cilësore të planifikuara në drejtim të veprimtarinë kontrolluese.

- Është përpjekur të zbatojë dhe të zhvillojë një metodologji bashkëkohore në kontroll, duke përgatitur, përmirësuar dhe përditësuar udhëzimet dhe metodikat përkatëse.

- Në auditimet financiare, u është dhënë përparësi sektorëve të ekonomisë apo subjekteve që janë vlerësuar me materialitet dhe risk të lartë. Auditimi i performancës duhet të zërë një vend më të gjerë në kontrollet dhe vlerësimet që bën institucioni.

- Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve.

- Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore.



- Ka përmirësuar veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe ka rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore.

- Është i nevojshëm përshejtimi më tej i ritmeve të kualifikimit të punonjësve dhe aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kuvendi vlerëson masat që po merr institucioni në lidhje me këtë çështje.

- Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike. Raporte më efektive duhet të krijohen me institucionet e hetimit.

- Ka përdorur fondet buxhetore në përputhje me kuotat e planifikuara sipas zërave të buxhetit.

**Kuvendi kërkon që, për vitin 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit të intensifikojë punën në këto drejtime:**

- Kryerjen e kontrolleve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë.

- Rritjen e efikasitetit të veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë drejt auditimit të performancës.

- Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikatat më të mira të vendeve të tjera.

- Harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese.

- Zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivelet bashkëkohore, si dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë.

- Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit.

- Rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

- Rritjen e transparencës ndaj medias dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e bashkëpunimit me botën akademike.

*26 prill 2012*

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

## **REZOLUTË** **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT** **TË KONKURENCËS PËR VITIN 2011**

**Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:**

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndryshuar me ligjin nr. 9499, datë 3.4.2006.

**Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:**

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Autoritetit për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve, në përputhje me politikën kombëtare të konkurrencës, normat dhe praktikat më të mira të administratës publike, si dhe të së drejtës europiane të konkurrencës;

- Nxitjes së konkurrencës së lirë dhe mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet ndërmarrjes së hetimit në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të sheqerit, të orizit, të shitjes me shumicë të vajit vegjetal, tregun e telekomunikacioneve, tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare etj.;

- Plotësimin dhe përmirësimin të kuadrit ligjor sekondar, duke reflektuar zhvillimet më të fundit të rregulloreve e praktikave më të mira të Bashkimit Europian, si dhe në përvojat tona;

- Rritjes së advokacisë dhe kulturës së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë dhe interaktiv me entet rregullatore e institucionet qendrore, shoqatat e biznesit dhe ato të mbrojtjes së konsumatorit, por edhe me publikun e gjerë;

- Rritjes së bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, për të forcuar rolin e Autoritetit në procesin e integritetit të vendit;

- Konsolidimit të shkallës së ekspertizës dhe të kapaciteteve administrative, që kanë ndihmuar në rritjen e shpejtësisë së veprimit, në përgjigje të ankesave dhe ndërtimit të taktikave në mënyrën e duhur, për të përmirësuar instrumentin e *down raids*-it;

- Rritjen e llojeve të tregjeve që kanë qenë objekt i monitorimit dhe i hetimeve, apo i kontrollit dhe vlerësimit të përqendrimit nga institucioni i konkurrencës.

**Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2012 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

- Plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor sekondar me rregullore dhe udhëzues, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e zbatimit të ligjit të konkurrencës, në përputhje me praktikat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian, në veçanti për nxitjen e konsolidimit e instrumentit të ankesës së operatorëve të tregut;

- Përfundimin e hetimeve të nisura, si dhe zgjerimin e thellimit të hetimeve në tregje, për të eliminuar deformimet e konkurrencës dhe për të mbrojtur konsumatorët;

- Rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve në tregjet ku shfaqen shenjat e kufizimit të konkurrencës, nëpërmjet përsosjes së teknikave investigative, nëpërmjet rritjes profesionale të punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës;

- Rritjen e kulturës për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës, duke promovuar partnerhipin dhe bashkëpunimin, kryesisht me komunitetin e biznesit;

- Ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm dhe publikut për rëndësinë e konkurrencës dhe rolin e Autoritetit në ruajtjen e saj, si dhe bashkëpunimin me ta në këtë proces;

- Rritjen e shpejtësisë së ndërhyrjeve në treg, nëpërmjet rritjes profesionale të punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës;

- Forcimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit ndër-institucional me entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike.

**Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:**

- Në dhënien dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e tregut dhe hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg;

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.

*19 prill 2012*

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**



**DEKRET**  
**Nr. 7401, datë 16.4.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                 |                              |
|---------------------------------|------------------------------|
| 1. Roland Ylli Liço             | 18. Spiro Thanasi Dhima      |
| 2. Vangjelia Vasil Kostiku      | 19. Ziko Leonidha Kostiku    |
| 3. Fatmir Sulejman Imeraj       | 20. Pandi Leonidha Kostiku   |
| 4. Arben Nebi Hata              | 21. Dhoksia Sotir Dhimulla   |
| 5. Vangjel Malo Sadedini        | 22. Mimoza Naun Duka         |
| 6. Taqi Jorgji Dhima            | 23. Vangjelica Çiço Sadedini |
| 7. Sofia Leonidha Dhima         | 24. Ismet Mustafa Berisha    |
| 8. Vasillo Nikolla Xhima        | 25. Servet Mustafa Berisha   |
| 9. Hasan Rustem Shehu           | 26. Selver Mustafa Berisha   |
| 10. Kujtim Rustem Shehu         | 27. Anila Kajta Berisha      |
| 11. Flora Rustem Shehu          | 28. Malbor Mehdi Asllani     |
| 12. Jani Thoma Papafoti         | 29. Isuf Sinan Alushi        |
| 13. Kostaq Vasil Mihallari      | 30. Feruze Rasim Alushi      |
| 14. Gjergji Kostaq Mihallari    | 31. Emiljan Isuf Alushi      |
| 15. Dhionis Apostol Mihallari   | 32. Janaq Isuf Alushi        |
| 16. Vasilika Themistokli Prifti | 33. Xhuljana Isuf Alushi     |
| 17. Lefteri Dhimo Lilo          | 34. Romeo Isuf Alushi        |

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr. 7421, datë 24.4.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Sebije Hasan Elezaj (Berisha)
2. Sadije Hasan Berisha (Berisha)

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr. 7423, datë 27.4.2012**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Loren Nikolla Kota
2. Najada Gëzim Thanasi
3. Marielle Klodian Ferro
4. Ariana Agron Çomo-Eismann (Çomo)

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 11.5.2012  
Doli nga shtypi më 14.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 42 lekë